

Ligj

Nr.7943, Datë 1.6.1995

**“PËR PENSIONET SUPLEMENTARE DHE INSTITUTET PRIVATE
TË PENSIONEVE” (NDRYSHUAR ME LIGJIN
NR. 8393, DATË 02.09.1998, LIGJIN NR. 9181, DATË 05.02.2004 DHE
LIGJIN NR.9572, DATË 3.07.2006)**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I :

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

**Neni 1
Përkufizimi**

1. Me termin “Ligj për Sigurimet Shoqërore” do të kuptohet Ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” .
2. Me termin “Sigurim shoqëror i detyrueshëm” do të kuptohet sigurimi sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” .
3. Me termin “Ligj” do të kuptohet ligji “Për pensionet suplementare dhe të instituteve private të pensioneve” .
4. * shfuqizuar
5. * shfuqizuar
6. Me termin “Sigurim suplementar” do të kuptohen përfitimet e siguruara sipas këtij ligji.

7. Me termin “Institut pensionesh” do të kuptohet një institucion financiar që siguron pensione suplementare dhe përfitime të tjera në këmbim të kontributeve të paguara sipas këtij ligji.

7/1. Me termin “Institut pensionesh i profesioneve të vështira” kuptohet një institucion financiar, që siguron pensione suplementare dhe përfitime të tjera për punonjësit e një degë të caktuar të ekonomisë, në këmbim të kontributeve të paguara sipas këtij ligji.

7/2. Me termin “Degë e vështirë e ekonomisë” kuptohet ajo degë ku kryhen punë, të cilat, për vështirësinë që paraqesin, janë kategorizuar si punë të kategorisë së parë dhe të dytë, për efekt përfitim pensioni nga sigurimet shoqërore.

8. Me termin “I aftë profesionalisht” do të kuptohet një person fizik, i cili ka kryer studimet universitare për ekonomi, drejtësi, matematikë ose degë të tjera të krahasueshme me to dhe ka praktikë në administrim me shumë se 3 vjet.

9. Me termin “I respektueshëm” do të kuptohet një person fizik i padënuar nga gjykata për krime të qëllimshme.

10. Me termin “Depozitar” * do të kuptohet banka që do të shërbejë si depozitë për institutin e pensioneve.

11. Termi “Punëdhënës” do të përfshijë çdo person fizik ose juridik që ka punësuar së paku një person të përcaktuar sipas pikës 12 të këtij neni.

12. Termi “Person i punësuar” do të përfshijë të gjithë personat që kanë kontratë pune për kohë të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës dhe me kusht që të jenë të siguruar sipas skemës së sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

13. Termi “Person i siguruar” do të përfshijë të gjithë personat me të cilët instituti i pensioneve ka nënshkruar një kontratë.

14. Me termin “kontratë sigurimi” do të kuptohet kontrata e lidhur me shkrim ndërmjet të siguruarit dhe institutit të pensioneve për sigurim suplementar dhe me anë të së cilës palët marrin përsipër detyrimet e parashikuara:

a) në këtë ligj;

b) në kontratë;

c) në rregulloren e pensioneve të institutit të pensioneve.

15. Me termin “Kontratë e aderimit të punëdhënësit me institutin e pensioneve” do të kuptohet kontrata që një punëdhënës nënshkruan me institutin e pensioneve për sigurimin suplementar të të punësuarve të tij dhe me kusht që të përmbushë detyrimet e vendosura në rregulloren e pensioneve dhe në statut.

16. Termi “Organe të vendosura me ligj” u referohet asamblesë së përgjithshme, bordit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës të institutit të pensioneve” .

17. Termi “Periudhë sigurimi” u referohet periudhave për të cilat paguhen kontribute.

18. Termi “Kontribute” do të thotë pagesa të rregullta të bëra nga i siguruari në institutin e pensioneve, për marrjen e përfitimeve në përputhje me këtë ligj.

Neni 2 Qëllimi

1. Ky ligj rregullon:

- a) sigurimin e pensioneve suplementare të dhëna nga institutet private të pensioneve suplementare;
- b) veprimtaritë e tyre;
- c) kontrollin e shtetit mbi këto institute.

2. Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i përfitimeve suplementare për të siguruarit në rastet e pensioneve të pleqërisë, invaliditetit dhe (ose) familjare me anë të rregullimeve suplementare të pensioneve, në shtesë të atyre që jepen nga ligji për sigurimin e detyrueshëm shoqëror.

Neni 3 Institutet e pensioneve

1. Institutet e pensioneve do të krijohen në përputhje me këtë ligj nga personat juridikë privatë, të cilët kanë marrë një autorizim të veçantë nga Autoriteti*.

2. Institutet e pensioneve do të krijohen me nje kapital të përbashkët nga të gjithë në përputhje me ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregëtare”, dhe regjistruar në përputhje me ligjin nr.7667, datë 28.1.1993 “Për regjistrimin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregëtare”.

Ligji nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregëtare” do të zbatohet për aq sa nuk bie në kundërshtim me këtë ligj.

3. Instituti i pensioneve do të jetë person juridik privat, që vepron në emër të tij, dhe mban çdo përgjegjësi për veprimet e tij dhe ato që rrjedhin prej tyre.

4. Përfitimet që nxjerr instituti i pensioneve do të përdoren në mënyrë ekskluzive në dobi të personave të siguruar në të, kurse 10 përqind e fitimit neto do t`u shpërndahet krijuesve të institutit, në raport me kapitalin e futur.

5. Institutet e pensioneve do të drejtohen nga mbajtësit e aksioneve (aksionistët) dhe administrimi mund të komisionohet në Institutin e Sigurimeve Shoqërore ose nga kompani profesioniste të specializuara.

6. Institutet e pensioneve do të kryejnë vetëm ato veprimtari që parashikohen nga ky ligj dhe të miratuara nga Autoriteti*.

Neni 4

Llojet e instituteve të pensioneve

1. Institutet e pensioneve mund të krijohen:

- a) Nga punëdhënësit, për të punësuarit e punëdhënësit, të cilët e themelojnë ose i bashkëngjiten atij;
- b) Nga një institucion financiar privat, i cili vepron për të gjithë personat fizikë me qëndrim të përhershëm në Shqipëri, duke përfshirë këtu dhe të punësuarit e punëdhënësve që lidhin një kontratë me këtë institucion.
- c) Nga punëdhënësit e së njëjtës degë të vështirë të ekonomisë, për të punësuarit e punëdhënësit, të cilët e themelojnë ose i bashkëngjiten atij.

2. Instituti i pensioneve mund të jetë:

- a) I mbyllur, vetëm për të punësuarit e punëdhënësve ose punëdhënësit, të cilët themelojnë institutin e pensioneve ose i bashkëngjiten atij apo lidhin një kontratë me të;
- b) I hapur që pranon edhe persona të tjerë, sipas kushteve të përcaktuara në rregulloren e pensioneve.

3. Instituti i pensioneve të profesioneve të vështira është i mbyllur vetëm për të punësuarit e punëdhënësve të një dege të caktuar të ekonomisë.

Neni 5 Punëdhënësit

1. Punëdhënësit mund të sigurojnë të punësuarit e tyre me pensione suplementare:

- a) duke krijuar një institut pensionesh, për të arritur qëllimet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 2;
- b) duke vendosur një grup punëdhënësish, të cilët mund të krijojnë bashkërisht një institut pensionesh;
- c) duke iu bashkëngjitur një instituti ekzistues pensionesh.
- d) duke lidhur një kontratë me një institut ekzistues pensionesh.

2. Një punëdhënës mund të bëjë marrëveshje për sigurim suplementar vetëm sipas njërës nga mënyrat e përshkruara në pikën 1, shkronja a ose b dhe c, ose të lidhë një kontratë vetëm me njërin nga siguresit sipas pikës 1, shkronja d. Nëse punëdhënësi është person fizik, ai mund të sigurojë me pensione suplementare punonjësit e tij vetëm duke lidhur një kontratë sipas shkronjës d të pikës 1 të këtij neni.

3. Punëdhënësit e ndërmarrjeve shtetërore jobuxhetore mund të krijojnë ose të aderojnë në një institut privat pensionesh vetëm me autorizim të Këshillit të Ministrave.

4. Punëdhënësit e ndërmarrjeve shtetërore buxhetore nuk mund të krijojnë dhe nuk mund të aderojnë në një institut privat pensionesh.

Neni 6 Personat e siguruar

1. Çdo sigurim suplementar do të jetë vullnetar, i bazuar në një kontratë individuale.

2. Quhet person i siguruar në lidhje me sigurimin suplementar, personi që:

a. ka mbushur moshën 18 vjeç;

b. ka banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;

c. ka lidhur një kontratë me shkrim me institutin e pensioneve.

Personat me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, mund të sigurohen në institutet private të pensioneve me kusht që në rast mosmarrëveshesh të zbatohet legjislacioni shqiptar.

Pjesëmarrja në sigurimin suplementar do të jetë vullnetare.

Neni 7

Skema e sigurimit suplementar mbështetet në sistemin e kontributeve. Masa e pensionit suplementar llogaritet mbi bazën e kontributeve të paguara, të rritura nga fitimi i veprimtarisë ekonomike të institutit privat të pensioneve siç është parashikuar në këtë ligj.

Neni 8

Punëdhënësi merr pjesë në fondin e institutit të pensioneve në atë rast që caktohet nga marrëveshja me personat e punësuar (të siguruarit).

Punëdhënësit e degëve të vështira të ekonomisë që kanë krijuar institut pensionesh të profesionave të vështira ose i janë bashkëngjitur atij, marrin pjesë në fondin e institutit, pavarësisht nga marrëveshja me personat e siguruar

Neni 9

Përfitimet nga sigurimi suplementar nuk taksohen.

Neni 10

Personat e siguruar në një institut pensionesh kanë të drejtë të transferojnë kontributet e tyre në një institut tjetër pensionesh në këto kushte :

- Pas nje viti nga krijimi i institutit ku është siguruar.
- Pas 3 vjetësh pagesë kontributesh në institut.
- Pas 6 muajsh që kanë deklaruar largimin.

Në kontratën e sigurimit mund të parashikohet edhe transferimi i kontributeve që punëdhënësi ka derdhur për sigurimin në institutin e pensioneve.

Personi i siguruar nuk ka të drejtë t'i transferojë kontributet në një institut tjetër pensionesh kur:

- a) ka plotësuar kushtet për pension suplementar;

b) është siguruar në një institut pensionesh të profesioneve të vështira dhe nuk e ka ndërruar punëdhënësin.

KREU II

KRIJIMI I INSTITUTIT TË PENSIONEVE

Neni 11

Themeluesit e Institutit të Pensioneve

1. Instituti i pensioneve mund të krijohet vetëm nga persona juridikë që e kanë qendrën në Shqipëri. Ata duhet të deklarojnë qëllimin e tyre me shkrim. Kur themeluesit e institutit të pensioneve humbasin rezidencën e tyre në Shqipëri, ata do t'ua tjetërsojnë aksionet e tyre personave të tjerë juridikë që plotësojnë kushtet e këtij ligji.

2. Punëdhënësi privat që ka më se 500 të punësuar, ka të drejtë të krijojë një institut pensionesh. Kur instituti i pensioneve krijohet nga më shumë se një punëdhënës të paktën njëri prej tyre duhet të ketë të punësuar më shumë se 100 persona dhe të gjithë së bashku të paktën 500 persona.

3. Punëdhënësi privat i një dege të vështirë të ekonomisë, me jo më pak se 300 persona të punësuar, ka të drejtë të krijojë një institut privat pensionesh të profesioneve të vështira. Kur instituti privat i pensioneve të profesioneve të vështira krijohet nga më shumë se një punëdhënës, duhet që njëri prej tyre të ketë të punësuar më shumë se 100 persona dhe të gjithë së bashku të kenë të punësuar jo më pak se 500 persona.

Neni 12

Deklarimi i qëllimit ose marrëveshja

1. Punëdhënësi që vendos të krijojë një institut pensionesh, duhet të firmosë një deklaratë për këtë qëllim. Kur disa punëdhënës vendosin të krijojnë një institut të përbashkët pensionesh, ata duhet të nënshkruajnë një marrëveshje për këtë qëllim.

2. Deklarata ose marrëveshja do të përmbajë;

a) emrin e institutit të pensioneve;

b) vendndodhjen e institutit të pensioneve;

c) emrin dhe qendrën e atyre që themelojnë këtë institut;

d) përcaktimin e veprimtarisë së institutit të pensioneve;

e) detyrimet për të përmbushur shpenzimet për krijimin e institutit të pensioneve;

f) vlerën minimale të një aksioni dhe shpërndarjen e aksioneve;

g) mënyrën me të cilët do të mblidhet dhe do të depozitohet dorëzënësia (garancia);

h) marrëveshjen se kush do të jetë depozitari* i deklaratës ose marrëveshjes i bashkëngjitet një parashikim për shpenzimet e pritshme të institutit të pensioneve.

3. Kur më tepër se një punëdhënës bashkohen për të krijuar një institut pensionesh, atëherë ata duhet të tregojnë në marrëveshjen e qëllimit atë punëdhënës që do t'i vishet fuqia e përfaqësimit të të gjitha palëve të interesuara.

4. Deklarata ose marrëveshja e qëllimit duhet të firmoset nga palët e interesuara.

Neni 13 **Krijimi i institutit të pensioneve**

1. Krijimi i institutit të pensioneve do të bëhet me autorizim nga Autoriteti* dhe do të regjistrohet si një shoqëri aksionare.

2. Në kërkesën për autorizim kërkuuesi duhet të specifikojë:

- a) emrin dhe vendndodhjen e institutit të pensioneve;
- b) madhësinë e kapitalit bazë të institutit të pensioneve;
- c) burimet e kapitalit bazë;
- d) kushtet materiale dhe organizative për veprimtarinë e institutit të pensioneve;
- e) emrat e anëtarëve të propozuar për drejtimin e përgjithshëm dhe këshillin mbikëqyrës të institutit privat të pensioneve, të cilët janë profesionalisht të aftë dhe përgjegjës;
- f) depozituesin për institutin e pensioneve.

Kërkuuesi, në aneks, duhet të shtojë një konfirmim të depozitës së dorëzënësisë së kërkuar dhe një çertifikate të Institutit të Sigurimeve Shoqërore që vërteton se të gjithë themeluesit kanë paguar kontributet e sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

3. Kërkesa për licencë* e krijimit të institutit të pensioneve duhet të shoqërohet nga:

- a) një deklaratë ose marrëveshje për qëllimin e krijimit të institutit të pensioneve;
- b) një deklaratë, e cila specifikon numrin minimal të të punësuarve të interesuar;
- c) Statuti i institutit të pensioneve;
- ç) rregullorja e pensioneve;
- d) plani i biznesit për 5 vjet;
- dh) përshkrimi i masave organizative dhe administrimi që do të merren për funksionimin e institutit të pensioneve.

4. Themeluesit e institutit të pensioneve do të kapitalizojnë një shumë në formë garancie prej jo më pak se 10 milion lekësh, në një bankë të autorizuar dhe që e ka qendrën në Shqipëri. Shuma e kapitalizuar do të bllokohet për 3 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit të institutit të pensioneve dhe pas kësaj do të kthehet në fond rezervë të institutit. Kur instituti do të likujdohet nga Autoriteti* për arsye të parashikuara në këtë ligj, garancia do të shërbejë për të mbuluar borxhet e mundshme të institutit. Çdo tepriçë u kthehet themeluesve.

5. Plani i biznesit do të përshkruajë çdo vit parashikimet për:

- a) numrin e personave pjesëmarrës në fond;
- b) të ardhurat nga kontributet;
- c) të ardhurat nga investimet e fondit;
- ç) shpenzimet paraprake që do të ndërmarrë organizimi;
- d) shumën që do të shpenzohet për përfitimet;
- dh) koston administrative të menaxhimit të fondit.

6. Përshkrimi i masave organizative dhe administrative përmban informacion për:
- a) hapësirat e zyrave;
 - b) pajisjen e zyrave;
 - c) stafin e institutit;
 - ç) teknologjinë e informacionit;
 - d) organizimin e menaxhimit.

Neni 14 Autorizimi

1. Autoriteti* do të autorizojë krijimin e institutit të pensioneve brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Nëse kërkesa nuk i përmban të gjithë elementët, Autoriteti* duhet të kërkojë që pretenduesi ta rishikojë dhe ta plotësojë kërkesën e tij. Koha që mund t'i nevojitet kërkuarit për të rishikuar a plotësuar kërkesën e tij nuk duhet të përfshihet në kohën kufi për marrjen e vendimit.

2. Autoriteti* duhet të refuzojë kërkesën në rastet:

- a) kur nuk përmbushen kërkesat për krijimin e institutit të pensioneve të përcaktuara në nenin 11, 12 dhe 13;
- b) kur rregullorja e pensioneve, rregullorja financiare dhe masat administrative e organizative nuk sigurojnë aftësinë paguese të institutit të pensioneve;
- c) kur deklarata ose marrëveshja e qëllimit, statuti, rregullorja e pensioneve dhe ajo financiare nuk përmbushin kërkesat e vendosura në këtë ligj;
- d) kur ndonjë nga themeluesit nuk ka paguar kontributet e sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

3. Autoriteti* tërheq një autorizim të lëshuar me pare në këto raste:

- a) kur kushtet për veprimtarinë e institutit të pensioneve, të përcaktuara në këtë ligj, janë shkelur rëndë dhe nuk mund të rregullohen;
- b) kur rregullorja e pensioneve dhe statuti i institutit të pensioneve janë shkelur në një mënyrë të tillë që instituti i pensioneve nuk mund të sigurojë me aftësinë e tij paguese.

Neni 15 Regjistrimi

1. Instituti i pensioneve, pas autorizimit, i cili duhet të kërkohet nga gjykata, krijohet duke filluar nga data e regjistrimit të tij në gjykatë.

2. Instituti i pensioneve njofton Autoritetin* brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit.

KREU III ORGANET DREJTUESE TË INSTITUTIT TË PENSIONEVE

Neni 16 Asambleja e përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme përbëhet nga dy dhoma:

- a) dhoma e aksionerëve;
- b) dhoma e përfaqësuesve të personave të siguruar.

Çdo dhomë zgjedh anëtarët e vet në Këshillin Mbikëqyrës. Dhoma e aksionerëve ka veton në çdo vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

1/1. Përfaqësuesit e personave të siguruar zgjidhen me votim të fshehtë nga të siguruarit një herë në 5 vjet. Mënyrat dhe rregullat e zgjedhjes përcaktohen në statutin e institutit të pensioneve.

2. Çdo aksionmbajtës do të ketë aq vota sa numri i aksioneve që ai zotëron në institutin e pensioneve.

3. Asambleja e përgjithshme:

- a) do të zgjedhë anëtarët e këshillit mbikëqyrës të institutit të pensioneve dhe do të kërkojë nga Autoriteti* miratimin e tyre;
- b) do të miratojë statutin e institutit të pensioneve;
- c) do të miratojë raportin vjetor të institutit të pensioneve;
- d) do të miratojë bilancin vjetor të institutit të pensioneve.

4. Asambleja e përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit për të miratuar:

- a) raportin vjetor të institutit të pensioneve;
- b) bilancin vjetor, llogaritë;
- c) raportin e këshillit mbikëqyrës për veprimtarinë ekonomike të institutit të pensioneve;
- d) ndryshimet e shtesat në statutin dhe rregulloren e pensioneve;
- e) dhe për të analizuar në çdo 2 vjet veprimtarinë e institutit të pensioneve në raport me parashikimet afatgjata.

5. Personat e siguruar do të përfaqesohen nga persona fizikë të zgjedhur në ndërmarrjet e punëdhënësve (punëdhënësit) që zotërojnë aksionet e institutit të pensioneve.

6. Përfaqësuesit do të zgjidhen një herë në 4 vjet nga të siguruarit. Zgjedhjet do të organizohen me interesimin e punëdhënësit. Kandidatët do të caktohen nga sindikatat ose nga çdo grup punonjësish prej jo më pak se 10 vetash.

Neni 17

Këshilli mbikëqyrës

1. Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 5 anëtarë zgjidhen nga aksionerët dhe 2 anëtarë nga përfaqësuesit e personave të siguruar në Asamblenë e Përgjithshme. Përfaqësuesit e aksionerëve, anëtarë të Këshillit mbikëqyrës, zgjedhin kryetarin dhe zëvendëskryetarin e parë të tij. Përfaqësuesit e personave të siguruar në Këshillin mbikëqyrës zgjedhin zëvendëskryetarin e dytë të tij. Në rast se ata nuk bien dakort për një gjë të tillë, Kryetari emëron njërin prej tyre si zëvendëskryetar të dytë të Këshillit mbikëqyrës. Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës zgjidhen për një afat 5 vjeçar.

2. Këshilli mbikëqyrës:

- a) zgjedh anëtarët e bordit drejtues;
- b) vendos për investimet e mëdha, kufiri i të cilave përcaktohet nga asambleja e përgjithshme;
- c) kërkon raporte të rregullta nga bordi drejtues;
- d) raporton në asamblenë e përgjithshme;

3. Rregullat do të përcaktohen në statutin e institutit të pensioneve.

Neni 18 Bordi drejtues

1. Bordi drejtues do të përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë të aftë profesionalisht, të zgjedhur nga këshilli mbikëqyrës. Një nga këta anëtarë do të zgjidhet si kryetar dhe një tjetër si zëvendëskryetar. Kryetari është përfaqësues i institutit të pensioneve. Të drejtat dhe detyrimet e tyre do të përcaktohen në statut.

2. Bordi drejtues:

- a) drejton institutin e pensioneve;
- b) ndërmer veprime financiare;
- c) raporton në Këshillin mbikëqyrës.

3. Rregullat do të përcaktohen në statut.

Neni 19 Pjesëmarrja e Autoritetit*

Autoriteti* ftohet të marrë pjesë në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme dhe të këshillit mbikëqyrës. Nëpunësit e urdhëruar* duhet të kenë në dispozicion të tyre dokumentet, që do të diskutohen në asamblenë e përgjithshme dhe në këshillin mbikëqyrës, me qëllim që të mundësohet studimi i tyre e të merren të gjitha masat e nevojshme, kur ato janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 20 Anëtarët e këshillit mbikëqyrës dhe të bordit drejtues

1. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës mund të rizgjidhen.

2. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës dhe të bordit drejtues të Institutit të Pensioneve mund të jenë personat fizikë mbi 18 vjeç që:

- a) kanë zotësi juridike për të vepruar;
- b) janë të respektueshëm;
- c) janë të aftë profesionalisht.

3. Anëtarët e bordit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës hiqen kur:

- a) dënohen për vepra penale;
- b) japin dorëheqje;

- c) janë të paaftë mendërisht ose fizikisht;
- d) zgjidhen ose emërohen në një funksion apo detyrë që bie ndesh me funksionin apo detyrën që kryejnë këto organe.

4. Nuk mund të jenë anëtarë të këshillit mbikëqyrës dhe të bordit drejtues:
Anëtarët e organeve drejtuese të instituteve të tjera të pensioneve, bankave ose shoqërive komisionere, shoqërive të kambizmit, bursave e shoqërive investuese.

5. Punëdhënesit e institutit të pensioneve, anëtarët e organeve drejtuese dhe të Autoritetit*, detyrohen të ruajnë sekretin mbi informacionin e marrë gjatë kryerjes së funksionit ose detyrës, ose në lidhje me këtë detyrë, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Këtë detyrim ata e kanë edhe pas përfundimit të detyrës ose punësimit.

6. Anëtarët e organeve drejtuese dhe punëdhënesit e institutit të pensioneve, si dhe të Autoritetit*, detyrohen të ruajnë sekretin mbi informacionin e marrë gjatë kryerjes së funksionit ose detyrës, apo në lidhje me këtë detyrë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj. Këtë detyrim ata e kanë edhe pas përfundimit të detyrës ose punësimit.

KREU IV

STATUTI DHE RREGULLORJA E PENSIONEVE

Neni 21

Statuti

1. Instituti i pensioneve vepron në bazë të statutit, të pranuar nga asambleja dhe të miratuar nga Autoriteti*.
2. Statuti përmban :
 - a) identitetin e themeluesve të institutit të pensioneve;
 - b) emrin e institutit të pensioneve;
 - c) selinë e institutit të pensioneve;
 - d) personat që do të sigurohen ;
 - e) shtrirjen e veprimtarive të institutit të pensioneve;
 - f) organet drejtuese, strukturën, përgjegjësit e tyre dhe procedurën e votimit;
 - g) numrin e anëtarëve në organet drejtuese, zgjedhjen e tyre, periudhën e ushtrimit të detyrës, tërheqjen dhe procedurën e zëvendësimit;
 - h) emrat e përfaqësuesve që kanë të drejtën e veprimit në emër të institutit të pensioneve;
 - i) mënyrën e pjesëmarrjes së personave të siguruar në organet drejtuese të institutit të pensioneve, kur ka të tillë ;
 - j) fondet dhe llogaritë që duhet të krijohen për veprimtarinë e institutit të pensioneve dhe kontrolli i tyre;
 - k) objektivat dhe qëllimet e politikave investuese të institutit të pensioneve, veçanërisht llojet e vlerave të pasurive që do të përftoheshin me anë të mjeteve financiare të institutit;
 - l) parimet e ekonomisë së institutit të pensioneve;
 - m) mënyrën e përdorimit dhe shpërndarjes së fitimit të përfutur;

- n) mënyrën e publikimit të raporteve në lidhje me ekonominë e institutit të pensioneve dhe ndryshimeve të statutit, si dhe informacionin se ku do të përdoren këto raporte;
- o) mënyrën e likuidimit të pasurisë, nëse instituti do të shpërbëhet dhe
- p) emrin dhe selinë e depozitarit*.

Neni 22

Rregullorja e pensioneve

1. Instituti i pensioneve mbledh kontribute dhe jep përfitime, në përputhje me rregulloren e pensioneve të pranuar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe të miratuara nga Autoriteti*. Një institut pensionesh mund të ketë me shume se një rregullore pensionesh. Në rast se një institut pensionesh ka më shumë se një rregullore pensionesh, personat e siguruar dhe punëdhënësi i tyre mund të zgjedhin rregulloren e pensioneve që ata e konsiderojnë më të mirë. Zgjedhja e tyre duhet të shprehet në kontratë.

2. Rregullorja e pensioneve përfshin:

- a) personat e siguruar dhe llojet e përfitimeve që do të sigurohen;
- b) kushtet e të qënit i përshtatshëm për të përfituar nga instituti i pensioneve, pagesën e përfitimeve ;
- c) metodën e llogaritjes së përfitimeve të siguruar nga instituti i pensioneve;
- d) arsyet e tërheqjes nga sigurimi të pensioneve suplementare;
- e) masën e kontributeve që të siguruarit paguajnë në institutin e pensioneve ;
- f) kushtet e shtyrjes ose të ndërprerjes së pagesës së kontributeve dhe ndryshimet në masën e tyre;
- g) rregullat dhe mënyrën e pagimit të kontributeve dhe procedurën që ndiqet në rastet e vonësës, mospagesës ose pagesës jo të rregullt të kontributeve;
- h) kushtet e transferimit të mjeteve financiare nga instituti i pensioneve suplementare në institute të tjera pensionesh dhe përcaktimi i të drejtave të bazuara në këtë transferim;
- i) parimet në bazë të të cilave pjesmarrësit, duke përfshirë edhe pensionistët, do të marrin pjesë në fitimet e ekonomisë së institutit të pensioneve.

3. Përfitimet përfshijnë :

- a) pensione shtesë për pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe (ose) familjare, mbi ato që sigurohen nga sigurimi shoqëror i detyrueshëm;
- b) përfitime të tjera afatgjata përsa u takon vjetërsisë në punë, pensioneve të parakohshme dhe shkëputjes nga pjesmarrja në institutin e pensioneve;
- c) përfitime të tjera shtesë, në natyrë dhe vlerë, mbi përfitimet e sigurimit të detyrueshëm shoqëror për subjektet e njohura nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror.

4. Rregullorja e pensioneve gjithmonë duhet të parashikojë pensione suplementare pleqërie.

5. Rregullorja e pensioneve duhet të parashikojë të paktën kushtet për të përfituar një pension pleqërie dhe caktimin e shumave të pagueshme njëherësh. Rregullorja e pensioneve mund të parashikojë kushte më të favorshme për të siguruarit, kur ato nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

6. Rregullores së pensioneve mund t'i bëhen shtesa dhe ndryshime, të cilat duhet të

miratohen nga Asambleja e përgjithshme dhe Autoriteti*.

Ndryshimet e shtesat kanë fuqi vetëm për kontratat e sigurimit që do të lidhen pas hyrjes në fuqi të tyre. Ndryshimet e shtesat do të kenë fuqi prapavepruese vetëm nëse pranohen nga klientët ekzistues, me të cilët është lidhur më parë kontratë sigurimi.

Shtesat dhe ndryshimet e bëra nga Asambleja e Përgjithshme, dhe të miratuar nga Autoriteti* depozitohen zyrtarisht pranë këtij Autoriteti*.

KREU V

KONTRATA E ADERIMIT TË PUNËDHËNËSVE NË INSTITUTIN E PENSIONEVE

Neni 23

Kontrata e aderimit të punëdhënësve

1. Një punëdhënës që dëshiron të sigurojë me pensione suplementare punonjësit e tij, mund të nënshkruajë një kontratë të aderimit të punëdhënësit me institutin e pensioneve. Themeluesit gjithmonë do të jenë të detyruar të nënshkruajnë një kontratë të tillë me institutin e pensioneve.
2. Kontrata e aderimit që punëdhënësi nënshkruan në favor të punonjësve të tij me institutin e pensioneve, përmban:
 - a) kushtet, sipas të cilave punëdhënësi është i gatshëm të paguajë kontribute në favor të punonjësve të tij;
 - b) pjesën e kontributeve, të cilën ai është dakort ta paguajë;
 - c) mënyrën dhe afatet e mbledhjes së kontributeve nga të punësuarit dhe transferimin e tyre në institutin e pensioneve;
 - d) datën në të cilën kontrata hyn në fuqi.
3. Punëdhënësi mund të prishë kontratën e tij të aderimit përpara fundit të muajit shtator të çdo viti kalendarik, me anë të një njoftimi me shkrim të bërë tre muaj përpara. Kontrata nuk mund të përfundojë përpara datës në të cilën punëdhënësi ka për të paguar të gjitha kontributet e tij në institutin e pensioneve. Punëdhënësi jo me vonë se një muaj nga data e përfundimit të kontratës është i detyruar t'ia kalojë gjithë informacionin përkatës institutit të pensioneve.
4. Themeluesi që prish kontratën e aderimit të punëdhënësit me institutin e pensioneve, i shet aksionet e tij të institutit të pensioneve zotëruesve të aksioneve që mbeten, ose me pëlqimin e tyre çdo personi tjetër juridik që përmbush kushtet e vendosura në këtë ligj dhe në statutin e institutit të pensioneve. Ato do të shiten me çmimin nominal të aksioneve ose me çmimin e tregut, cili të jetë më i ulët.
5. Kontrata e punëdhënësit zgjidhet në datën në të cilën punëdhënësi ose instituti i pensioneve do të shpërbëhet.

Neni 24
Detyrimet e palëve në kontratën e aderimit të punëdhënësit

Kontrata e aderimit të punëdhënësit e detyron punëdhënësin, duke filluar nga data e nënshkrimit:

- a) të paguajë kontributet për punonjësit që janë siguruar nga instituti i pensioneve, në atë masë që është vendosur në kontratën e aderimit të punëdhënësit me institutin e pensioneve;
- b) të mbledhë kontributet dhe t'i transferojë ato në institutin e pensioneve;
- c) të paraqesë në institutin e pensioneve informacion për punonjësit dhe kontributet e tyre, si dhe masën aktuale që duhet të transferohet në llogaritë e tyre personale dhe
- d) të përmbushë detyrimet e punëdhënësit të vendosur në këtë ligj, statut, rregulloren e pensioneve dhe në kontratën e aderimit të punëdhënësit.

KREU VI

KONTRATA E SIGURIMIT

Neni 25
Llojet e kontratave të sigurimit

Një person fizik mund të nënshkruajë:

- a) Kontratën e sigurimit të përgjithshëm për institutet e pensioneve private të hapura;
- b) Kontratën e sigurimit për institutet e pensioneve private të mbyllura.

Neni 26
Kontrata e sigurimit të përgjithshëm

1. Çdo person i përcaktuar në nenin 6 mund të nënshkruajë një kontratë sigurimi me një institut pensionesh.

2. Kontrata e sigurimit duhet të bëhet me shkrim dhe:

- a) të identifikojë personin që nënshkruan një kontratë sigurimi;
- b) të përcaktojë masën e kontributit që personi për gatitet të paguajë;
- c) të përcaktojë kushtet e veçanta, individuale, për të përfituar nga instituti i pensioneve;
- d) të përcaktojë personin fizik që do t'i jepet përfitimi në rastin e vdekjes së të siguarit;
- e) të caktojë datën në të cilën kontrata e sigurimit do të hyjë në fuqi,
- ë) zgjedh njëri nga rregulloret e pensioneve në rast se instituti i pensioneve ofron më shumë se një rregullore pensionesh.

3. Nëse punëdhënësi i një personi të tillë vendos të kontribuojë në favor të të siguarit, ai mund ta bëjë këtë në marrëveshje me personin e interesuar. Një kontratë e tillë do të jetë një çështje private ndërmjet palëve të interesuara dhe nuk do të ketë lidhje me detyrimet dhe të drejtat e personit të siguar dhe të institutit të pensioneve.

Neni 27

Kontrata e sigurimit profesional

1. Një i punësuar, i cili është i përshtatshëm sipas kushteve të vendosura në kontratën e aderimit të punëdhënësve, mund të nënshkruajë një kontratë sigurimi me institutin e pensioneve, për të qenë i mbuluar nga instituti i pensioneve.

2. Instituti i pensioneve do të jetë i detyruar të nënshkruajë një kontratë të tillë me çdo person të punësuar të një punëdhënës që ka nënshkruar një kontratë aderimi me institutin e pensioneve, me kusht që ai të përmbushë kushtet e vendosura në kontratën e aderimit të punëdhënësit. Një punonjës që nënshkruan një kontratë të tillë sigurimi, do të mbrohet si i siguruar në të gjitha aspektet e përcaktuara në kontratën e sigurimit.

3. Një i punësuar mund të lidhë kontratë të sigurimit profesional vetëm nëse:

- a) punëdhënësi i tij ka lidhur me institutin e pensioneve një kontratë të aderimit të punëdhënësve;
- b) ai ka arritur moshën e përcaktuar në kontratën e aderimit të punëdhënësve me institutin e pensioneve;
- c) është i punësuar sipas një kontrate me këtë punëdhënës, kontrata nuk parashikon kufi kohor dhe është e vlefshme të paktën për më tepër se gjysma e kohës së punës ditore ose mujore, sipas rastit.

Instituti i pensioneve në rregulloren e tij të pensioneve ose punëdhënësit në kontratën e tyre të aderimit mund të parashikojnë kushte të tjera përsa i përket lidhjes së kontratave profesionale të sigurimit, me kusht që ato të mos bien në kundërshtim me këtë ligj.

4. Kontrata profesionale e sigurimit duhet të përshkruajë:

- a) kushtet e të qenit i mbuluar nga ky sigurim;
- b) detyrimet e të punësuarve dhe të punëdhënësve për të paguar kontribute;
- c) detyrimet e institutit të pensioneve për përfitime, ashtu siç përcaktohet në rregulloren e pensioneve.

Kontrata gjithashtu duhet të përfshijë datën në të cilën fillon sigurimi dhe deklaratën e të punësuarit për pranimin nga ai të statutit të institutit të pensioneve.

5. Rregullorja e pensioneve do të jetë një shtesë e detyrueshme dhe e bashkëngjitur me kontratën profesionale të sigurimit. Kurdoherë që përmirësohet ose i bëhet shtesë, rregullorja e përmirësuar ose e shtuar e pensioneve do të bashkëngjitet kontratës profesionale të sigurimit dhe do të zëvendësojë rregulloren e pensioneve paraardhëse në aneks të kontratës.

6. Kontrata profesionale e sigurimit prishet:

- a) në datën kur punonjësi i siguruar prish kontratën me punëdhënësin, i cili ka lidhur një kontratë të aderimit me institutin e pensioneve, ose
- b) në datën kur punëdhënësi ose instituti i pensioneve është shpërbërë.

7. Një person i siguruar, gjithashtu mund të prishë kontratën përpara fundit të çdo muaji

me një lajmërim me shkrim të bërë një muaj më parë.

KREU VII

KONTRIBUTET

Neni 28

Kontributet e paguara në një institut të të përgjithshëm të pensioneve

1. Kontributi minimal të jetë jo më pak se 500 lekë në muaj ose një shumëfish i tij, siç është përcaktuar në kontratën e sigurimit.

2. Kontributet sipas këtij neni do ti paguhen paradhënie.

Neni 29

Kontributet e paguara në institutin profesional të pensioneve

1. Kontributet paguhen:

- a) në nivel minimal, ose
- b) si një përqindje e pagës bruto të të siguruarit, pa zbritur taksat.

2. Punëdhënësi është i detyruar të paguajë në institutin e pensioneve të profesioneve të vështira një kontribut në masën jo më pak se 50 për qind të totalit të kontributit për pjesëmarrje në fond. Kontributet në institutin e pensioneve të profesioneve të vështira paguhen nga i siguruari e punëdhënësi dhe derdhen nga punëdhënësi. Rregullat do të caktohen në rregulloren e pensioneve dhe në kontratën e aderimit të punëdhënësit. Kontributet në institutin profesional të pensioneve paguhen nga i siguruari dhe derdhen nga punëdhënësi.

3. Kontributet sipas këtij neni do të paguhen me prapapagim, në 15 ditëshin e parë të muajit që pason muajin për të cilin paguhen kontributet.

Neni 30

Pagesat dhe gjobat

1. Mënyra e pagesës së kontributeve dhe dispozitat në lidhje me to caktohen në rregulloren e pensioneve.

2. Rregullorja e pensioneve përcakton:

- a) gjobat për kontributet e paderdhura;
- b) kushtet sipas të cilave mund të bëhet marrëveshje me institutin e pensioneve për vonesat në pagimin e kontributeve;
- c) periudhën gjatë së cilës kontributet nuk do të paguhen.

Neni 31

Transferimi i kontributeve

1. I siguruari ka të drejtë të transferojë kontributet e tij, së bashku me pjesën e tij të fitimit nga një institut pensionesh në një institut tjetër pensionesh, në kushtet e nenit 11 dhe kur:
 - a) instituti tjetër i pensioneve është dakord me një transferim të tillë;
 - b) i siguruari të mos ketë marrë ndonjë kompesim nga instituti i pensioneve.

2. Instituti i pensioneve është i detyruar të bëjë transferimin, sipas pikës 1, brenda 6 muajve nga data në të cilën është paraqitur në institutin e pensioneve kërkesa e të siguarit për këtë transferim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet nga marrëveshja me institutin tjetër të pensioneve, që parashikohet në pikën 1/a të këtij neni.

KREU VIII

PËRFITIMET

Neni 32

Përfitimet

1. Instituti siguron:
 - a) pensione;
 - b) përfitime të pagueshme në formën e pagesave të menjëhershme;
 - c) shlyerje.

2. Rregullorja e pensioneve përcakton kushtet, datat sipas të cilave instituti i pensioneve paguan përfitimet dhe madhësinë e tyre.

Neni 33

Pensionet

1. Sipas kushteve të përcaktuara në rregulloren e pensioneve, instituti i pensioneve siguron:
 - a) pensione pleqërie, ku kushti i të qenit i përshtatshëm, në çdo rast jo më pak se 40 vjeç për gratë dhe 45 vjeç për burrat, është arritja e moshës;
 - b) pension invaliditeti, ku kushti për të qenë i përshtatshëm është dhënia e një pensioni invaliditeti sipas skemës së sigurimit të detyrueshëm shoqëror;
 - c) pension për vjetërsi në punë, ku kushti i të qenit i përshtatshëm është arritja e periudhës së sigurimit të pensioneve suplementare;
 - d) pension familjar, ku kushti i të qenit i përshtatshëm është vdekja e personit të siguar.

2. Aty ku rregullorja e pensioneve përcakton si kusht të qenit i përshtatshëm për një pension pleqërie ose invaliditeti një periudhë të caktuar sigurimi, duhet që i siguruari të ketë paguar të paktën 60 muaj kontribute.

3. Aty ku rregullorja e pensioneve përcakton si kusht për të qenë i përshtatshëm për një pension për vjetërsi pune në një periudhë të caktuar, duhet që periudha e kërkuar e sigurimit të jetë të paktën 180 muaj kalendarike. Kufiri i kësaj periudhe nuk mund të ulet nga rregullorja e pensioneve.

4. Pensioni familjar i sigurohet një personi fizik të përcaktuar nga i siguruari në kontratën e tij të sigurimit. I siguruari mund të përcaktojë më shumë se një person për këtë qëllim. Pensioni familjar mund të i paguhet personit fizik të përcaktuar në kontratë nga i siguruari, sipas kushteve të rregullores së pensioneve, deri në madhësinë e llogarisë.

5. Vetëm personi i siguar mund të jetë i përshtatshëm për të përfituar një pension pleqërie, invaliditeti dhe vjetërsie në punë.

Neni 34

Përfitimet e pagueshme në formën e shumave të menjëhershme

Përfitimet e pagueshme si shuma të menjëhershme kur ekzistojnë kushtet për pension paguhen:

- a) sipas kushteve të përcaktuara në rregulloren e pensioneve;
- b) kurdoherë që i siguruari ose pensionisti ndërpret qëndrimin e tij të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 35

Shlyerjet

1. Një person i siguar ka të drejtë të përfitojë shlyerje në formën e kthimit të kontributeve, me kusht që:

- a) të ketë përfunduar sigurimin e tij të pensioneve suplementare;
- b) të ketë paguar kontribute të paktën për 12 muaj kalendarike;
- c) të mos ketë përfituar nga e drejta për pension;
- d) kontributet e tij të mos jenë transferuar në një institut tjetër pensionesh.

2. Personi fizik, i përcaktuar nga personi i siguar, ka të drejtën për shlyerje nëse:

- a) i siguruari vdes;
- b) të siguarit nuk i është dhënë një pension ose një përfitim i pagueshëm si shumë e menjëhershme;
- c) asnjë nuk ka përfituar një pension familjar.

3. Shlyerja do të llogaritet si shumë:

- a) e kontributeve të paguara nga i siguruari dhe
- b) e pjesës së tij të fitimeve në veprimtarinë e institutit të pensioneve.

4. Instituti i pensioneve do ta japë shlyerjen brenda 3 muajve nga data e bërjes së kërkesës për këtë qëllim në institutin e pensioneve.

5. Pika 1, shkronja “ b” e këtij neni nuk do të zbatohet për personat, kontrata e të cilëve prishet si rezultat i ndryshimeve strukturore të bëra nga ana e punëdhënësit që ka

nënshkruar kontratën e aderimit me institutin e pensioneve.

6. Në rastet kur të siguruarit nuk përcaktojnë ndonjë person fizik për të marrë përfitimin në rastin e vdekjes, ky përfitim do t'i nënshtrohet dispozitave mbi trashëgiminë.

Neni 36

Mbrojtja e së drejtës për të përfituar

1. Çdo i siguruar ka të drejtë:

- a) të kontaktojë për çdo lloj përfitimi që parashikohet në rregulloren e pensioneve;
- b) të transferojë kontributet e tij dhe të punëdhënësit të tij, së bashku me pjesën e tij të fitimit, në një institut tjetër pensionesh në të cilin ka aderuar punëdhënësi i tij i ri.

2. Çdo anëtar në skemë ka të drejtë të jetë i informuar plotësisht, të paktën një herë në vit, për bilancin financiar të institutit dhe veprimtarinë e tij.

2/1. Institutet e pensioneve të profesioneve të vështira janë të detyruara:

- a) të njoftojnë me shkrim, të paktën një herë në vit, pjesëmarrësit në institut për nivelin e të gjitha të ardhurave të regjistruara për përfitimet e tyre. Ky njoftim duhet të përfshijë bilancin financiar dhe të dhëna për administrimin e institutit të pensioneve të profesioneve të vështira, personelin e bordit drejtues dhe të këshillit mbikëqyrës, numrin e pjesëmarrësve në institut, si dhe ndryshimet në rregulloren e pensioneve, transferimin e fondeve, etj.

- b) të dërgojnë me shkrim të dhëna për nivelin e të ardhurave të regjistruara në llogarinë e pjesëmarrësit për përfitimin për kë i takon.

2/2 Rregullorja e pensioneve, të dhënat për administrimin e institutit të pensioneve të profesioneve të vështira, për personelin e bordit drejtues dhe këshillin mbikëqyrës, për numrin e pjesëmarrësve, përfshirë edhe të gjitha ndryshimet në njoftimin e mësipërm, duhet të publikohen në zyrën ku është regjistruar instituti. Këto të dhëna duhet të jenë të vlefshme për të gjithë pjesëmarrësit në institutin e pensioneve të profesioneve të vështira.

3. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët i drejtohen gjykatës.

KREU IX

FINANCIMI DHE INVESTIMET

Neni 37

Rregullat baze

1. Shteti nuk mban përgjegjësi financiare për institutin e pensioneve dhe rezultatet e operacioneve të tij financiare.

2. Instituti i pensioneve do të krijojë një kapital dhe një fond rezervë.

3. Një institut pensionesh të profesioneve të vështira është i detyruar të krijojë fond rezervë për mbulimin e humbjeve dhe për garantimin e pagesës së përfitimeve, i cili të mbulojë të paktën tre muaj shpenzime për përfitime.

Fondi rezerve për mbulimin e humbjeve krijohet nga fitimi i institutit të pensioneve të profesioneve të vështira, si rezultat të investimeve të tij.

Në rast se investimi i institutit të pensioneve të profesioneve të vështira rezulton me humbje dhe fondi rezervë, si dhe çdo fond tjetër i krijuar nga fitimi, janë të pamjaftueshëm për mbulimin e humbjeve, humbjet mbulohen prej të ardhurave të mbledhura në institut për përfitimet e pjesëmarrësve. Humbjet mund të mbulohen edhe me një kredi pa interes ose kredi të garantuara nga punëdhënësi.

Neni 38 **Politika e investimeve**

1. Të paktën 50 përqind e pasurisë së institutit të pensioneve të investohet në një vend të sigurt në:

- a) interesa të konsoliduar;
- b) obligacione të emetuara nga bankat;
- c) obligacione të njohura publikisht, të emetuara nga shoqëritë tregtare dhe të pranuar për tregti në bursat e fondeve;
- d) aksionet e njohura publikisht dhe çertifikatat e pjesëmarrjes së pranueshme për tregtim në bursën e fondeve;
- e) pasuri të luajtshme të ndryshme nga sigurimet, duke i'u referuar shkronjave "a" deri "d" që paraqesin garanci për investime të sigurta të institutit;
- f) toka dhe pasuri të tjera të paluajtshme që japin fitime të rregullta dhe shërbejnë plotësisht ose kryesisht për sipërmarrje a për jetesë.

2. Instituti i pensioneve mund të blejë letra me vlerë për jo më tepër, ose të shesë për jo më pak se çmimi që letra me vlerë është tregtuar në tregun publik në ditën e shitjes ose të blerjes së saj.

3. Vlera e letrave me vlerë e një emetuesi e tregtuar në bursën e fondeve nuk duhet të kalojë 10 përqind të pasurisë së institutit të pensioneve. Ky kufizim nuk ka vlerë në rastin e interesave të konsoliduara.

4. Vlera e çfarëdo pasurie të paluajtshme ose të luajtshme nuk duhet të kalojë 5 përqind të pasurisë së institutit të pensioneve.

5. Instituti i pensioneve nuk duhet të zotërojë më tepër se 20 përqind të vlerës totale të letrave me vlerë të emetuara nga çdonjëri prej emetuesve dhe të tregtuara në bursë.

6. Porcionet e përmendura në pikat e mësipërme mund të tejkalohen për një periudhë jo më tepër se 6 muaj, kur bëhet blerja e sforcuar dhe preventive për shkak të ndryshimeve në vlerat e obligacioneve dhe të ndryshimeve në vlerësimin e pasurive të paluajtshme e të luajtshme, me kusht që brenda 6 muajve shpërndarja e rrezikut për të humbur do të jetë

në përputhje me pikat e mëparshme.

7. Instituti i pensioneve do të jetë i detyruar të vërë menjëherë në dijeni Autoritetin* për tejkalimin e kufijve të parashikuar në këtë nen.

8. Një institut pensionesh i profesioneve të vështira është i detyruar të arrijë një nivel minimal fitimi, të barabartë me normën e interesit të konsoliduar të sistemit bankar.

Neni 39 **Shpërndarja e fitimeve**

Instituti i pensioneve shpërndan fitimin e tij në një mënyrë të tillë që të paktën 5 përqind e tij të shkojë për fondin rezervë, jo më shumë se 10 përqind për dividendin e shpenzime të tjera në përputhje me vendimin e asamblesë së përgjithshme, me kusht që të mos ketë nje dispozitë tjetër që të bëjë rregullimin më vonë, 10 përqind formuesve të kapitalit, pjesa që mbetet u shpërndahet të siguruarve.

Neni 40 **Llogaria**

1. Llogaria e institutit të pensioneve i nënshtrohet të gjitha rregullave si dhe llogarisë së skemës së sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

2. Për çdo të siguar do të ketë nje llogari të veçantë për kontributet e tij, si dhe për ato që janë paguar nga punëdhënësi i tij për pjesën e tij në fitimin e veprimtarisë së institutit të pensioneve.

3. Instituti i pensioneve vendos kontributet e të siguarit dhe të punëdhënësit të tij në llogarinë e të tretëve.

4. Mjetet financiare, të cilat janë baza e llogaritjes për pensionet për vjetërsi shërbimi dhe invaliditeti, mbahen në llogari të veçanta.

5. Instituti i pensioneve paraqet për shqyrtim në Autoritet*:

- a) bilancin vjetor, së bashku me raportin vjetor të institutit të pensioneve;
- b) parashikimin aktual për tre vitet që pasojnë dhe
- c) rregulloren financiare të vitit në vazhdim.

6. Vlera e letrave me vlerë në zotërim të institutit të pensioneve duhet të llogaritet mbi bazën e vlerës së tyre në treg në ditën që bëhet vlerësimi.

7. Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të vlerësohen përpara blerjes herë pas here sipas afateve të përcaktuara në statut dhe të paktën një herë në vit. Vlerësimi duhet të jetë sipas legjislacionit që është në fuqi në kohën e blerjes së tyre. Kur nuk ka legjislacion të përshtatshëm, vlerësimi duhet të behet nga gjykata.

8. Llogaritja e ndryshimeve të vlerës së pasurisë së institutit të pensioneve, që shkaktohen

si pasojë e ndryshimeve të vlerës së letrave me vlerë dhe të vlerësimit të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, do të bëhet në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi në këtë fushë.

Neni 41 Raportimi

1. Instituti i pensioneve do të jetë i detyruar të publikojë raporte për ekonominë e tij në fund të çdo 3-mujori dhe në fund të çdo viti kalendarik.
2. Institutet e pensioneve që funksionojnë për më tepër se 3 vjet, do të përfshijnë në raportin e tyre për ekonominë edhe rezultatet e arritura në tre vjetët e fundit.
3. Raporti për ekonominë do t'u jepet gjithashtu Autoritetit* dhe depozituesit.

Neni 42 Mbrojtja e informacionit

1. Të dhënat e një instituti pensionesh mund të shfrytëzohen vetëm me pëlqimin e këtij instituti.
2. Informacioni në lidhje me të siguarin mund të përdoret vetëm me pëlqimin e këtij të fundit, me përjashtim të rasteve kur ky informacion kërkohet nga ministria ose Autoriteti* brenda kompetencave të kontrollit të tyre.

KREU X LIKUIDIMI I INSTITUTIT TË PENSIONEVE

Neni 43

1. Instituti i pensioneve do ta mbyllë veprimtarinë e tij në datën kur:
 - a) fshihet nga regjistri;
 - b) është deklaruar falimentimi;
 - c) integrohet në një institut tjetër pensionesh;
 - d) ndahet në më tepër se një institut pensionesh.
2. Instituti i pensioneve e mbyll veprimtarinë e tij vetëm me pëlqimin e Autoritetit*.
3. Pasuria e institutit të pensioneve për shlyerje do të transferohet në një institut tjetër, nëse ai institut merr përsipër detyrimet e të parit. Nëse nuk ka vazhdimësi ligjore, duhet të fillojë procesi i likuidimit.
4. Të gjitha të drejtat e fituara nga personi i siguar do të kompensohen nga instituti i pensioneve. Pensionet do të zëvendësohen me pagesa të njëhershme, nëse nuk bihet dakord për ndonjë mënyrë tjetër pagesë. Nëse pasuria e institutit të pensioneve nuk lejon të kompensohen komplet të drejtat e fituara, atëherë kompensimi do të bëhet në raport

proporcional me pasurinë e mbetur të këtij instituti.

5. Likuiduesi do të caktohet nga Autoriteti*.

KREU XI INSPEKTIMI DHE INSPEKTORIATI

Neni 44

* shfuqizohet

KREU XII DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 45

Këshilli i Ministrave, kur është e nevojshme, nxjerr rregullore në lidhje me inspektimin.

Neni 46

Në rastet kur për krijimin, hyrjen në fuqi dhe veprimtarinë e institutit të pensioneve nuk ka dispozita të veçanta në këtë ligj, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil, të Kodit të Punës e të Kodit të Familjes.

Neni 47

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve” kudo ku është përdorur fjala “autorizim” zëvendësohet me fjalën “leje” dhe kudo ku është përdorur shprehja “institut i pensioneve” zëvendësohet me shprehjen “institut privat i pensioneve” parashikuar në nenin 15 të ligjit nr.8393, datë 2.9.1998 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”.

Shpallur me dekretin nr.1128, datë 16.6.1995

të Presidentit të Republikës

*Ndryshuar me Ligjin Nr.9572, datë 03.07.2006, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 78, viti 2006

